



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. ____ prot

Tiranë, më ____ . ____ .2026

NJOFTIM

**PËR APLIKIM NË REGJISTRIN SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE
E TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË PËR VITIN 2026**

Të nderuar kolegë/e,

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, mbështetur në ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”, pikës 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 28.02.2019, të ndryshuar me VKM nr. 148, datë 06.03.2025, për disa shtesa në VKM nr. 104 datë 28.02.2019 “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë”, Urdhrit nr. 413, datë 26.07.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatave për nxënësit në diasporë”, VKM-së nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) **shpall në faqen zyrtare njoftimin: Për aplikim në regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë për vitin 2026.**

Mësuesit e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë (kandidatët) të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar me rrugë postare ose me rrugë elektronike brenda afateve të përcaktuara në këtë njoftim.

1. Afati i aplikimit është nga data 1 qershor– 30 shtator 2026.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u regjistruar në regjistrin shtetëror të mësuesve:

- a) Të jenë diplomuar në fushën e mësuesisë në institucionet e arsimit të lartë. Përparësi kanë mësuesit e diplomuar në degët gjuhë shqipe dhe letërsi, parashkollor, arsim fillor, histori, gjeografi, etnologji, muzikë dhe arte të kulturës shqiptare.
- b) Të jenë licencuar si mësues, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës apo vendeve ku zhvillohet program i mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
- c) Të jenë pranuar si mësues i mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në vendet respektive.

4. Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët:

- a) Kërkesë për aplikim sipas shtojcës 1 bashkëlidhur
- b) Curriculum vitae me fotografi sipas formatit EUROPASS, shoqëruar me dokumentacionin që shoqëron të dhënat në CV.
- c) Kopje e një dokumenti identifikimi: pasaportë apo kartë identiteti.
- d) Kopje e diplomës, në fushën e mësuesisë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (bachelor dhe master ose e integruar).
- e) Kopje e listës së notave, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.
- f) Kopje e licencës së mësuesisë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar (nëse disponon një të tillë).
- g) Kopje të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara të certifikatave dhe të kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të marra në Shqipëri ose në vende të tjera (*nëse e disponon një të tillë*).
- h) Dokument që vërteton se kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (të saktësohet nëse është institucion publik apo privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme), *me përjashtim të rasteve kur ky dokument lëshohet nga përfaqësitë diplomatike.*

5. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën postare: ASCAP, Rruga Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë.

Shënim: Dokumentacioni i pikës 4/d.e.g.f.h duhet të dorëzohet i noterizuar dhe (i përkthyer në gjuhën shqipe për ato të cilët e kanë në gjuhë të huaj)

Ju Faleminderit,